



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 95

Tiranë – E mërkurë, 27 maj 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 406, datë 20.5.2020	Për miratimin e rregullave “Për etiketimin e ushqimit për kafshë, që përdoren për ushqim, përfshirë dhe ato që kanë në përbërje ose përmbajnë organizma të modifikuar gjenetikisht”..... 5573
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 3/2, datë 11.5.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 3, datë 24.2.2020 “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të ndryshuar..... 5584
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr.142, datë 13.5.2020	Për përcaktimin e adresave të postës elektronike për komunikimin zyrtar me Ministrinë e Drejtësisë 5586
Vendim i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit nr. 9, datë 11.5.2020	Për transferimin e funksionit të mbledhjes së tarifave për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në administrimin kolektiv dhe drejtimin e sportelit unik të administrimit të së drejtës së autorit – SUADA..... 5587

**VENDIM****Nr. 406, datë 20.5.2020****PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE “PËR ETIKETIMIN E USHQIMIT PËR KAFSHË, QË PËRDOREN PËR USHQIM, PËRFSHIRË DHE ATO QË KANË NË PËRBËRJE OSE PËRMBAJNË ORGANIZMA TË MODIFIKUAR GJENETIKISHT”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 56, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave “Për etiketimin e ushqimit për kafshë, që përdoren për ushqim, përfshirë dhe ato që kanë në përbërje ose përmbajnë organizma të modifikuar gjenetikisht”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe ushqimin dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

¹ Ky vendim është përafshuar pjesërisht me:

- Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 767/2009, datë 13 qershor 2009, “Për vendosjen në treg dhe përdorimin e ushqimit për kafshë”, që amendon rregulloren nr. 1831/2003, dhe shfuqizon direktivën e Këshillit 79/373/KEE, direktivën 80/511/KEE, direktivën 82/471/KEE, 83/228/KEE, 93/74/KEE, 93/113/KE dhe 96/25/KE; numri CELEX 32003R0767; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 229, datë 1.9.2009, faqe 1–41;

- Rregulloren (KE) nr. 1829/2003, e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në datën 22 shtator 2003, për sa u përket ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë gjenetikisht të modifikuara; numri CELEX 32003R1829, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 268, datë 18.10.2003, faqe 1–23.

RREGULLA**PËR ETIKETIMIN E USHQIMIT PËR KAFSHË, QË PËRDOREN PËR USHQIM, PËRFSHIRË DHE ATO QË KANË NË PËRBËRJE OSE PËRMBAJNË ORGANIZMA TË MODIFIKUAR GJENETIKISHT****1. Qëllimi**

Qëllimi i këtyre rregullave është përcaktimi i mënyrës së etiketimit të ushqimit për kafshë që përdoret për ushqim, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të sigurisë së ushqimit për kafshë, të mbrojtjes së shëndetit publik, sigurimin e informacionit të përshtatshëm për përdoruesit dhe funksionimin efektiv të tregut të brendshëm.

2. Fushat e zbatimit

a) Këto rregulla përcaktojnë mënyrën e etiketimit, të:

i. ushqimit konvencional, për kafshë që përdoren për ushqim;

ii. OMGJ-ve, që përdoren si ushqim për kafshë;

iii. ushqimit për kafshë që përmban ose përbëhet nga OMGJ-të;

iv. ushqimit për kafshë të prodhuar nga OMGJ-të.

b) Këto rregulla nuk zbatohen për etiketimin e ushqimeve konvencionale për kafshë:

i. që nuk përdoren për ushqim;

ii. që përdoren për konsum vetjak dhe që nuk kanë si qëllim vendosjen në treg të tij;

iii. që përmbajnë lëndë të para, të cilat përbëhen ose janë prodhuar nga OMGJ-të, në një përqindje jo më shumë se 0,9 për qind të ushqimit për kafshë dhe të ushqimit për kafshë, të përbërë, kur kjo prani është aksidentale/e paqëllimshme ose teknikisht e pashmangshme.

Për të demonstruar që prania e këtyre lëndëve është e paqëllimshme ose teknikisht e pashmangshme, operatorët duhet të jenë në gjendje t'i paraqesin autoritetit kompetent të kontrollit zyrtar informacione dhe dokumente bindëse, që kanë ndërmarrë masat e duhura për të shmangur praninë e këtyre lëndëve;

iv. të medikuara.

3. Përkufizime

Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim edhe në këto rregulla, ndërsa me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:



a) “Të ushqyerit e kafshëve nga goja”, futja e ushqimit për kafshë në traktin gastrointestinal nëpërmjet gojës, me synim plotësimin e kërkesave për ushqim të kafshës, si dhe mbajtjen e prodhimit të kafshëve të shëndosha.

b) “Kafshë e destinuar për prodhimin e ushqimeve”, çdo kafshë e ushqyer, e mbarështuar dhe e mbajtur për prodhimin e ushqimeve për njerëz, si dhe kafshë të cilat nuk mbahen për konsum njerëzor, por u përkasin llojeve të cilat normalisht janë të destinuara për konsum njerëzor.

c) “Lëndë të para për ushqimin për kafshë”, prodhime me origjinë bimore ose shtazore, qëllimi kryesor i të cilave është të plotësojnë nevojat ushqimore të kafshëve, në gjendje natyrale të freskët ose të konservuar, si dhe derivatet e përpunimit industrial të tyre dhe substanca organike ose inorganike që përmbajnë ose jo aditivë për ushqimet e kafshëve, në gjendje natyrale ose pas transformimit apo në përgatitjen e ushqimeve të përbëra ose të përdorura si mbështetës për paramishelat.

ç) “Ushqim i përbërë për kafshë”, përzierja e të paktën dy lëndëve të para për ushqim për kafshë, që përmbajnë ose jo aditivë për ushqim për kafshë, të destinuara për ushqyerjen e kafshëve nga goja në formën e ushqimeve të plota ose plotësuese.

d) “Ushqime të plota për kafshë”, ushqime të përbëra, që, për sa i përket përbërjes së tyre, janë të mjaftueshme për plotësimin e nevojave ditore.

dh) “Ushqime plotësuese për kafshë”, ushqimet për kafshë, në përbërjen e të cilave ka një nivel të lartë të disa substancave, por që përfshirja e tyre në një racion ushqimor plotëson nevojat ditore vetëm nëse shoqërojnë ushqime të tjera për kafshë.

e) “Ushqime minerale për kafshë”, ushqime plotësuese për kafshë të cilat përmbajnë të paktën 40% hi të papërpunuar.

ë) “Ushqime për kafshë që ushqehen me qumësht”, ushqime të përbëra për kafshë, që u jepen kafshëve në periudhën e ushqyerjes me qumësht, në gjendje të thatë ose të tretur, në një sasi të caktuar uji, të destinuara për ushqyerjen e kafshëve të reja si plotësuese ose në zëvendësim të qumështit të nënës pas periudhës së kulloshtres ose të destinuara për ushqyerjen e kafshëve të reja, si: viça, qengja ose keca të destinuar për therje.

f) “Qëllime të veçanta ushqyese”, qëllimi i plotësimit të disa nevojave të veçanta të të ushqyerit të kafshët, procesi i asimilimit, i

përthithjes ose i metabolizmit të të cilave është përkohësisht ose në mënyrë të pakthyeshme i dëmtuar dhe prandaj përfitojnë nga marrja e ushqimit të duhur për gjendjen e tyre.

g) “Ushqime të destinuara për qëllime të veçanta ushqyese”, ushqime për kafshë, që plotësojnë një qëllim të caktuar ushqimor, si rrjedhojë e përbërjes së veçantë të tyre apo e mënyrës së veçantë të prodhimit të tyre, që i diferencon ato në mënyrë të qartë nga ushqimet e tjera për kafshë. Në këtë grup nuk futen ushqimet e medikuara.

gj) “Ushqim i medikuar”, ushqimi për kafshë, të cilit i shtohen substanca fizike, kimike, biokimike, mikrobiologjike, me qëllim kurimin e një sëmundjeje të caktuar. Përfshihen nga ky grup substancat koksidiostatike dhe histomonostatike.

h) “Materiale ndotëse”, substanca fizike, kimike dhe biologjike të cilat janë të padëshirueshme dhe dëmtojnë shëndetin e kafshëve dhe të njerëzve që konsumojnë produktet me origjinë shtazore.

i) “Jetëgjatësia minimale e ruajtjes”, periudha gjatë së cilës garantohet që një ushqim i dhënë, në kushtet e duhura të ruajtjes, ruan të gjitha cilësitë e tij të deklaruara në etiketë. Përcaktohet vetëm një datë e jetëgjatësisë minimale për çdo ushqim për kafshë dhe përcaktimi bëhet në bazë të jetëgjatësisë minimale të secilit prej përbërësve të tij.

j) “Parti/loti”, një sasi e identifikueshme ushqimi për kafshë që ka karakteristika të përbashkëta, si: origjina, varieteti, tipi i ambalazhit, ambalazhuesi, dërguesi ose etiketimi dhe në rastin e një procesi prodhimi të pandërprerë, një njësi prodhimi ose më shumë njësi prodhimi, të prodhuara në një stabiliment të vetëm, duke zbatuar parametra prodhimi uniforme, kur prodhohen në vazhdimësi dhe të magazinuara në të njëjtin stabiliment.

k) “Etiketë”, çdo qafore e shkruar, markë, emër tregtar, konfigurim, përshkrim ose simbol për një ushqim për kafshë, i shkruar, i printuar, i shtypur, i shënuar, i stampuar, i fiksuar ose i ngjitur në ambalazh ose në kontejnitorin e ushqimit për kafshë.

l) “Ushqim për kafshë i modifikuar gjenetikisht”, ushqimi për kafshë, që përmban, përbëhet ose prodhohet nga OMGJ-të.

ll) “OMGJ që përdoren si ushqim për kafshë”, një OMGJ që përdoret si ushqim për kafshë ose si lëndë e parë për prodhimin e ushqimit për kafshë.



m) “Prodhuar nga OMGJ-të”, që rrjedh në tërësi ose pjesërisht nga OMGJ-të, por që nuk përmban ose përbëhet nga OMGJ-të.

n) “Homologu konvencional”, një ushqim për kafshë i ngjashëm, i prodhuar pa ndihmën e modifikimit gjenetik dhe për të cilin ekziston një histori e përdorimit të sigurt.

nj) “Autoriteti kompetent”, institucioni shtetëror që kryen kontrollin zyrtar për zbatimin e kërkesave të këtij vendimi (AKU).

4. Kërkesat e sigurisë dhe të marketingut

a) Ushqimet për kafshë etiketohen dhe vendosen në treg vetëm nëse janë të sigurt.

b) Operatorët e biznesit të ushqimit për kafshë, që prodhojnë dhe tregtojnë ushqime për kafshë, sigurojnë që ushqimet për kafshë që përdoren për ushqim, të tregtohen të ambalazuara dhe të etiketohen në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.

5. Parimet për etiketimin dhe prezantimin

a) Etiketimi dhe prezantimi i ushqimeve për kafshë, që përdoren për ushqim, nuk duhet të keqinformojë përdoruesin, në veçanti:

i. lidhur me përdorimin e parashikuar ose karakteristikat e ushqimit për kafshë që përdoren për ushqim, në veçanti, natyrën, mënyrën e prodhimit, vetitë, përbërjen, sasinë, jetëgjatësinë, llojet dhe kategoritë e kafshëve për të cilat është i destinuar të përdoret;

ii. duke i atribuar ushqimit për kafshë efekte dhe veti që nuk i ka ose, duke sugjeruar që ushqimi për kafshë zotëron karakteristika të veçanta, kur në fakt të gjitha ushqimet e ngjashme për kafshë kanë të njëjtat karakteristika.

b) Lëndët e para për ushqimin për kafshë ose ushqimet e përbëra për kafshë, që tregtohen të paambalazuara ose në kontejnerë të hapur, shoqërohen me një dokument, i cili përmban të gjithë treguesit e detyrueshëm të etiketimit të përcaktuar në këtë vendim.

c) Kur ushqimi për kafshë ofrohet për shitje, me anë të komunikimit në largësi, sipas mënyrave të përcaktuara në ligjin “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të dhënat e detyrueshme të etiketimit, përveç atyre të përcaktuara në pikat 9, shkronjat “b”, “ç” dhe “d”; 10, shkronja “b”, nënndarjet “ii” dhe “iii”, dhe 11, shkronja “a”, nënndarja “iv”, paraqiten nëpërmjet materialeve që mbështesin shitjen në distancë, përpara lidhjes së kontratës së shitjes. Informacioni sipas pikave 9,

shkronjat “b”, “ç” dhe “d”; 10, shkronja “b”, nënndarjet “ii” dhe “iii” dhe 11, shkronja “a”, nënndarja “iv”, i paraqitet blerësit në momentin e dorëzimit të ushqimit për kafshë.

ç) Kërkesa të përgjithshme shtesë për etiketimin e ushqimit për kafshë, që përdoren për ushqim, paraqiten në shtojcën I të këtyre rregullave.

d) Tolerancat e lejuara për mospërputhjet midis vlerave të deklaruara në etiketë, për përbërësit e lëndëve të para të ushqimit për kafshë ose të ushqimeve për kafshë të përbëra dhe vlerave që rezultojnë nga analizat e kryera, për qëllim të kontrolleve zyrtare, përcaktohen në shtojcën II, të këtyre rregullave. Analizat laboratorike të mostrave, të marra për kryerjen e kontrollit zyrtar të ushqimit për kafshë kryhen në laboratorët e AKU-së ose të ISUV-it, në përputhje me nenin 59, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar.

6. Përgjegjësitë dhe detyrimet e operatorit të biznesit të ushqimit për kafshë, që përdoren për ushqim

a) Përgjegjës për etiketimin është operatori i biznesit ushqimor për kafshë, i cili vendos për herë të parë në treg një ushqim për kafshë ose, kur është e përshtatshme, operatori i biznesit ushqimor për kafshë nën emrin ose emrin e biznesit të të cilit tregtohet ushqimi për kafshë.

b) Operatori përgjegjës për etiketimin:

i. garanton praninë në etiketë dhe saktësinë e të gjithë treguesve të etiketimit të përcaktuar në këto rregulla;

ii. siguron që informacioni i dhënë nëpërmjet çdo lloji mjeti të jetë në përputhje me kërkesat e me këto rregulla.

c) Operatorët e biznesit ushqimor për kafshë, të shitjes me pakicë ose të shpërndarjes, që nuk ndikojnë në etiketim, duhet të ndihmojnë në sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat e etiketimit, të përcaktuara në këto rregulla, në veçanti, duke shmangur furnizimin dhe shpërndarjen e ushqimit për kafshë, për të cilin kanë informacion që nuk është në përputhje me kërkesat e këto rregulla.

ç) Operatorët e biznesit ushqimor për kafshë marrin të gjitha masat e duhura që të dhënat e detyrueshme të etiketimit të transmetohen përgjatë gjithë zinxhirit ushqimor, në mënyrë që informacioni t’i jepet përdoruesit të fundit të ushqimit për kafshë, në përputhje me kërkesat e këtyre rregullave.



d) Operatori përgjegjës për etiketimin e ushqimit për kafshë, që përdoren për ushqim, i mundëson autoritetit kompetent çdo informacion lidhur me përbërjen dhe vetitë e deklaruara të veçanta të ushqimit për kafshë që përdoren për ushqim, të vendosur në treg, i cili lejon verifikimin e saktësisë së informacionit të dhënë në etiketë, përfshirë përqindjet e sakta në peshë të lëndëve të para të përdorura në ushqimet e përbëra për kafshë që përdoren për ushqim.

7. Deklarimet e veçanta

a) Etiketimi dhe prezantimi i lëndëve të para për ushqimet për kafshë dhe i ushqimeve të përbëra për kafshë që përdoren për ushqim mund të tërheqë vëmendje të veçantë lidhur me praninë ose mungesën e një substance të dhënë në ushqimin për kafshë, një karakteristike ushqyese ose procesi apo të një funksioni të veçantë të tyre, me kusht që të përmbushin kriteret e mëposhtme:

i. deklarimi të jetë i verifikueshëm nga autoriteti kompetent dhe i kuptueshëm për përdoruesin e ushqimit për kafshë;

ii. operatori përgjegjës për etiketimin paraqet me kërkesë të autoritetit kompetent prova shkencore mbi deklarimet e veçanta, duke dhënë referencën për të dhënat shkencore të publikuara ose nëpërmjet kërkimeve shkencore të dokumentuara, të kryera nga biznesi ushqimor për kafshë. Provat shkencore duhet të jenë të disponueshme në momentin e vendosjes në treg të ushqimit për kafshë, që përdoren për ushqim. Blerësit kanë të drejtë t'i bëjnë të ditur autoritetit kompetent dyshimet e tyre për vërtetësinë e deklarimeve të veçanta. Kur arrihet në përfundimin që një deklarim nuk vërtetohet, paraqitja në etiketë e këtij deklarimi konsiderohet shkelje e parimeve për etiketimin dhe prezantimin. Në rastet kur autoriteti kompetent ka dyshime për vërtetësinë shkencore të një deklarimi të veçantë, merr masat e duhura sipas legjislacionit në fuqi.

b) Pa përjashtuar kërkesat e shkronjës “a” të kësaj pike, deklarimet lidhur me përmirësimin e të ushqyerit, të forcimit ose të mbrojtjes së kushteve fiziologjike, lejohen me kusht që të jenë në përputhje me nënndarjen “i”, të shkronjës “c”, të kësaj pike.

c) Në etiketimin ose në paraqitjen e lëndëve të para për ushqimin për kafshë ose të ushqimeve të përbëra për kafshë nuk duhet të deklarohet se ushqimi për kafshë:

i. parandalon, trajton ose kuron një sëmundje, me përjashtim të koksidiostatikeve dhe histomonostatikeve të autorizuar, sipas legjislacionit në fuqi. Megjithatë, kjo pikë nuk zbatohet për deklarimet lidhur me ushqyerjen e pabalancuar, me kusht që të mos ketë asnjë simptomë patologjike të lidhur me të;

ii. ka një qëllim të veçantë ushqyës, përveç rasteve kur i plotëson kërkesat e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fuqi.

8. Paraqitja e treguesve në etiketë

a) Treguesit e detyrueshëm të etiketimit paraqiten në tërësinë e tyre në një vend të dukshëm në ambalazh, kontejner, në një etiketë bashkëngjitur në to ose në dokumentacionin shoqërues të përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 5, të këtyre rregullave, në mënyrë të lexueshme dhe që nuk fshihen lehtë, të paktën në gjuhën shqipe. Etiketimi i ushqimeve për kafshë që importohen të jetë edhe në gjuhën shqipe.

b) Treguesit e detyrueshëm të etiketimit të jenë lehtësisht të dallueshëm dhe të mos mbulohen nga informacione të tjera. Ato paraqiten me ngjyra, shkrim dhe madhësi të tilla që nuk errësojnë ose theksojnë një pjesë të informacionit, përveç rastit kur bëhet për të tërhequr vëmendjen ndaj deklaratave parandaluese.

9. Kërkesat e përgjithshme të detyrueshme të etiketimit

Lëndët e para për ushqimin për kafshë ose ushqimet e përbëra për kafshë që përdoren për ushqim, nuk vendosen në treg nëse etiketa nuk përmban treguesit e mëposhtëm:

a) Lloji i ushqimit për kafshë që përdoren për ushqim: “lëndë e parë për ushqim për kafshë që përdoren për ushqim”, “ushqim i plotë për kafshë që përdoren për ushqim” ose “ushqime plotësuese për kafshë që përdoren për ushqim”, dhe sipas rastit:

i. për “ushqimin e plotë për kafshë që përdoren për ushqim”, emërtimi “ushqim i plotë për kafshë, zëvendësues i qumështit” përdoret, kur është e përshtatshme;

ii. për “ushqimin plotësues për kafshë që përdoren për ushqim” emërtimet, “ushqim mineral për kafshë” ose “ushqim plotësues për kafshë, zëvendësues i qumështit”, përdoren kur është e përshtatshme;



b) Emri ose emri i biznesit dhe adresa e operatorit të biznesit ushqimor për kafshë që përdoren për ushqim, përgjegjësi për etiketimin;

c) Kur është e mundur, numri dhe data e licencës së operatorit të biznesit ushqimor për kafshë, përgjegjësi për etiketimin;

ç) Numri i lotit ose i partisë së produktit;

d) Sasia neto e shprehur në njësi mase, për produktet e ngurta dhe në njësi mase ose volumi për produktet e lëngshme;

dh) Lista e aditivëve për ushqimet e kafshëve, të paraprirë nga fjala “aditivët”, në përputhje me shtojcën IV, pa cenuar legjislacionin në fuqi për aditivët që përdoren në ushqimin për kafshë;

e) Përmbajtja e lagështirës, në rastet kur ajo kalon nivelet e mëposhtme:

- 5%, në rastin e ushqimeve minerale për kafshë që nuk përmbajnë substanca organike;

- 7%, në rastin e ushqimeve për kafshë zëvendësuese të qumështit dhe ushqimet e tjera të përbëra për kafshë, me përmbajtje të produktit qumësht, më të madhe se 40%;

- 10%, në rastin e ushqimeve minerale për kafshë, që përmbajnë substanca organike;

- 14%, në rastin e ushqimeve të tjera për kafshë.

10. Kërkesa të veçanta të detyrueshme për etiketimin e lëndëve të para për ushqimet e kafshëve

a) Përveç kërkesave të përcaktuara në pikën 9 të këtyre rregullave, etiketimi i lëndëve të para për ushqimet e kafshëve që përdoren për ushqim duhet të përfshijë edhe:

i. emrin e lëndës së parë;

ii. deklarin e detyrueshëm për çdo kategori të lëndës së parë, siç përcaktohet në listën e shtojcës III të këtyre rregullave.

b) Kur aditivët përfshihen në lëndët e para për ushqim për kafshë, përveç kërkesave sipas shkronjës “a” të kësaj pike, etiketimi i lëndëve të para për ushqimet e kafshëve përfshin edhe:

i. llojin dhe kategoritë e kafshëve për të cilat është e destinuar lënda e parë e ushqimit për kafshë, në qoftë se aditivët nuk janë të autorizuar për të gjitha llojet dhe kategoritë e kafshëve ose janë autorizuar me kufizime maksimale për disa lloje kafshësh;

ii. udhëzimet për përdorimin e duhur, në përputhje me pikën 3, të shtojcës I, të këtyre rregullave, ku përcaktohet përmbajtja maksimale e aditivëve të caktuar;

iii. jetëgjatësia minimale për aditivët, të ndryshëm nga aditivët teknologjikë.

11. Kërkesa të veçanta të detyrueshme për etiketimin e ushqimeve të përbëra për kafshë

a) Përveç kërkesave të përcaktuara në pikën 9 të këtyre rregullave, etiketimi i ushqimeve të përbëra për kafshë përfshin edhe:

i. llojet dhe kategoritë e kafshëve për të cilat është destinuar ushqimi i përbërë për kafshë;

ii. udhëzimet për përdorimin e duhur të tyre, duke treguar qëllimin për të cilin ushqimi për kafshë është e destinuar. Këto udhëzime, kur është e zbatueshme, duhet të jenë në përputhje me pikën 3, të shtojcës I, të këtyre rregullave;

iii. në rastin kur prodhuesi nuk është përgjegjës për etiketimin, duhet të jepet edhe informacioni, si më poshtë vijon:

- emri ose emri i biznesit dhe adresa e prodhuesit; ose

- numri i licencës së prodhuesit, referuar shkronjës “c”, të pikës 9, të këtyre rregullave;

iv. jetëgjatësia minimale e ruajtjes, në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

- “të përdoret përpara ...”, e ndjekur nga data që tregon ditën, në rastin e ushqimit për kafshë që priset shpejt si pasojë e proceseve të shpërbërjes;

- “të përdoret përpara ...”, e ndjekur nga data që tregon një muaj të caktuar, për ushqimet e tjera të kafshëve. Kur në etiketë shkruhet data e prodhimit të ushqimit për kafshë, atëherë duhet të jepet edhe data që tregon jetëgjatësinë minimale të ruajtjes, ... (periudha kohore në ditë ose muaj) pas datës së prodhimit;

v. lista e lëndëve të para nga të cilat përbëhet ushqimi për kafshë, paraprirë nga fjala “përbërja” dhe duke treguar emrin e çdo lënde të parë, në përputhje me nënndarjen “i”, të shkronjës “a”, të pikës 10, duke listuar lëndët e para në mënyrë zbritëse në peshë, të llogaritur në bazë të përmbajtjes së lagështisë në ushqimin e përbërë për kafshë. Kjo listë përfshin edhe përqindjen në peshë të secilit përbërës;

vi. të dhënat e detyrueshme të përcaktuara në kapitullin II, të shtojcës IV, të këtyre rregullave.

b) Për sa i përket listës së përcaktuar në nënndarjen “v”, të shkronjës “a”, të kësaj pike, zbatohen kërkesat e mëposhtme:

i. emri dhe përqindja në peshë e lëndëve të para për ushqim për kafshë paraqiten nëse prania e tyre



është treguar në etiketë me fjalë, fotografi ose pikturë;

ii. nëse përqindjet në peshë të lëndëve të para në përbërje të një ushqimi të përbërë për kafshë që prodhojnë ushqim, nuk tregohen në etiketë (për ruajtjen e të drejtave të autorit), operatori i biznesit ushqimor për kafshë, përgjegjës për etiketimin, i mundëson blerësit, me kërkesë të tij, informacione mbi të dhënat e përbërjes sasiore, brenda një intervali saktësie $\pm 15\%$ të vlerës, sipas formulimit të ushqimit për kafshë.

c) Në rastet e emergjencave lidhur me shëndetin e njerëzve, të kafshëve ose të mjedisit, autoriteti kompetent i mundëson blerësit informacionin referuar shkronjës “d”, të pikës 6, të këtyre rregullave, pasi ka vlerësuar se dhënia e informacionit është e justifikuar, duke ruajtur interesat e prodhuesit dhe të blerësit. Nëse është e nevojshme, autoriteti kompetent i jep këto informacione pas nënshkrimit të një dokumenti ligjor, ku blerësi deklaron ruajtjen e konfidencialitetit të tyre.

12. Të dhëna të detyrueshme shitesë për etiketimin e ushqimeve për kafshë, që përdoren për qëllime të veçanta ushqyese

Përveç kërkesave të përgjithshme, të detyrueshme dhe të veçanta, të përcaktuara në pikat 9, 10 dhe 11, të këtyre rregullave, etiketimi i ushqimeve për kafshë që përdoren për qëllime të veçanta ushqyese, përfshin edhe kërkesat e mëposhtme:

a) Shprehja “dietetike” vendoset pranë emërimit të ushqimit për kafshë, të përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 9, të këtyre rregullave, vetëm në rastet e ushqimeve për kafshë që përdoren për qëllime të veçanta ushqyese;

b) Të dhënat e përcaktuara për përdorimin përkatës, sipas legjislacionit për përdorimet e ushqimit për kafshë për qëllime të veçanta ushqyese;

c) Një tregues që duhet të kërkohet mendimi i një eksperti për ushqyerjen e kafshëve (zooteknik) ose veteriner, para përdorimit të ushqimit ose përpara zgjatjes së periudhës së përdorimit.

13. Përrjashtime

a) Të dhënat e përcaktuara në shkronjat “c”, “ç”, “d” dhe “e”, të pikës 9 dhe nënndarjen “ii”, të shkronjës “a”, të pikës 10, nuk kërkohen, kur, përpara çdo transaksioni, blerësi ka deklaruar me

shkrim se nuk e kërkon këtë informacion. Një transaksion mund të përbëhet nga disa dërgesa.

b) Për ushqimet e ambalazuara, të dhënat sipas shkronjave “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 9 dhe të nënndarjes “iii”, të shkronjës “b”, të pikës 10, ose në nënndarjet “iii”, “iv” dhe “v”, të shkronjës “a”, të pikës 11, paraqiten në ambalazh jashtë etiketës, referuar shkronjës “a”, të pikës 9, në këtë rast duhet treguar vendi ku ato shfaqen.

c) Të dhënat e detyrueshme të përcaktuara nënndarjen “vi”, të shkronjës “a”, të pikës 11, nuk kërkohen për përzjerjet e drithërave, të farave dhe të frutave.

ç) Në rastin e ushqimeve për kafshë të përbëra, që përmbajnë jo më shumë se tri lëndë të para, të dhënat e detyrueshme, sipas nënndarjeve “i”, “ii”, të shkronjës “a”, të pikës 11, nuk kërkohen të paraqiten kur lëndët e para të përdorura tregohen qartë në përshkrim.

d) Për sasitë e lëndëve të para ose të ushqimeve të përbëra për kafshë, që nuk kalojnë 20 kg, të destinuara për përdoruesin e fundit dhe që shiten të hapura, të dhënat e përcaktuara në pikat 9, 10 dhe 11, të këtyre rregullave, i paraqiten blerësit nëpërmjet afishimit në një vend të dukshëm në pikën e shitjes. Në këto raste, të dhënat e përcaktuara në pikat 9, shkronja “a”; 10, shkronja “a”, ose 11, shkronja “a”, nënndarjet “i” dhe “ii”, i jepen blerësit me faturën e shitjes.

14. Kërkesat për etiketimin e ushqimeve për kafshë, të modifikuara gjenetikisht

a) Pa cenuar kërkesat për etiketimin të përcaktuara në këto rregulla, për ushqimin për kafshë të përcaktuar në nënndarjet “ii”, “iii”, “iv”, të shkronjës “a”, të pikës 2, etiketimi i tyre duhet të plotësojë edhe kërkesat, sipas shkronjës “c” të kësaj pike.

b) Operatorët e biznesit ushqimor për kafshë vendosin në treg ushqimin për kafshë të përcaktuar në nënndarjet “ii”, “iii”, “iv”, të shkronjës “a”, të pikës 2, të këtyre rregullave, vetëm nëse të dhënat e përcaktuara në nënndarjet “i”, “ii”, “iii”, “iv”, të shkronjës “c”, të kësaj pike, tregohen në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të qëndrueshme, në dokumentet shoqëruese ose, sipas rastit, në ambalazh, në kontejner ose në etiketën e produktit.

c) Çdo ushqim për kafshë, nga i cili përbëhet një ushqim i caktuar për kafshë, u nënshtrohet kërkesave të mëposhtme:



i. për OMGJ-të që përdoren si ushqim për kafshë dhe ushqimin për kafshë, që përmban ose përbëhet nga OMGJ, shprehja “emri i organizmit i modifikuar gjenetikisht” vendoset në kllapa, menjëherë pas emrit specifik të ushqimit për kafshë. Në mënyrë alternative, këto fjalë vendosen me shënim në fund të listës së ushqimit për kafshë. Në këtë rast, ato duhet të shkruhen me shkronja të paktën me të njëjtën madhësi me shkrimin e listës së ushqimit për kafshë;

ii. për ushqimet për kafshë të prodhuara nga OMGJ-të, shprehja “prodhuar nga (emri i organizmit) i modifikuar gjenetikisht” vendosen në kllapa, menjëherë pas emrit specifik të ushqimit për kafshë. Në mënyrë alternative, këto fjalë vendosen me shënim në fund të listës së ushqimit për kafshë. Ato duhet të shkruhen me shkronja të paktën me të njëjtën madhësi me shkrimin e listës së ushqimit për kafshë;

iii. siç specifikohet në autorizim, etiketa e OMGJ-ve që përdoret si ushqim për kafshë, ushqimit për kafshë që përmban ose përbëhet nga OMGJ-të, ushqimit për kafshë të prodhuar nga OMGJ-të, që janë të ndryshëm nga analogu i tyre konvencional, duhet të përmbajë karakteristikat e përcaktuara më poshtë:

- përbërjen;
- vetitë ushqyese;
- përdorimin e caktuar/destinuar;
- implikimet për shëndetin e specieve ose kategorive të caktuara të kafshëve;

iv. siç specifikohet në autorizim, etiketa përmban çdo karakteristikë ose veti që ushqimi për kafshë shkakton një problem etik ose fetar.

ç) Përveç kërkesave të përcaktuara në nënndarjet “i” dhe “ii”, të shkronjës “c”, të kësaj pike, dhe siç specifikohet në autorizim, etiketimi ose dokumentet shoqëruese të OMGJ-ve që përdoren si ushqim për kafshë, ushqimit për kafshë që përmban ose përbëhet nga OMGJ-të dhe ushqimit për kafshë të prodhuar nga OMGJ-të, që nuk kanë një homolog konvencional, duhet të përmbajnë edhe një informacion të përshtatshëm në lidhje me natyrën dhe karakteristikat e këtij ushqimi për kafshë.

SHTOJCA I

Kërkesat e përgjithshme për etiketimin, siç përcaktohet në shkronjën “ç”, të pikës 5, të këtyre rregullave:

1. Përmbajtjet ose nivelet të shënuara, ose që duhen deklaruar për peshën e ushqimit për kafshë, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe;

2. Tregimi i datave të bëhet sipas këtij rendi: dita, muaji dhe viti dhe shkruhet në etiketë me shkurtimet: “DD.MM.VV”;

3. Udhëzimet për përdorimin e duhur të ushqimeve plotësuese për kafshë dhe lëndëve të para për ushqimet e kafshëve që përmbajnë aditivë, në sasi më të mëdha se nivelet maksimale të përcaktuara për ushqimet e plota për kafshë, duhet të përmbajnë sasinë maksimale:

- në gram ose kg ose njësi volumi të ushqimit plotësues dhe të lëndëve të para për ushqim për kafshë, për kafshë, për ditë; ose

- në përqindje të racionit ditor; ose

- për kg të ushqimit të plotë për kafshë ose përqindje të ushqimit të plotë për kafshë,

në mënyrë që të sigurohet se respektohen nivelet maksimale të aditivëve për ushqimet e kafshëve në racionin ditor që marrin kafshët.

SHTOJCA II

Tolerancat e lejuara në etiketimin e përmbajtjes së lëndëve të para për ushqimet e kafshëve ose të ushqimeve të përbëra për kafshë, sipas kërkesave të shkronjës “d”, të pikës 5.

A. Toleranca për përbërësit analitikë, sipas shtojcave III dhe IV

1. Tolerancat e përcaktuara në këtë pikë kompletojnë devijimet teknike dhe analitike. Tolerancat analitike janë të fiksuara dhe i përkasin kufirit të gabimit në matje dhe të ndryshimeve procedurale. Si rrjedhojë, vlerat e përcaktuara në pikën 2 të kësaj shtojce, duhet të përshtaten në mënyrë që të prekin vetëm tolerancat procedurale.

2. Kur ndeshen ndryshime të vlerave të përbërjes së një lënde të parë për ushqimet e kafshëve ose ushqimi të përbërë për kafshët, me vlerat e shënuara në etiketë të përbërësve të përmendur në shtojcat III dhe IV, zbatohen tolerancat që vijnë:



Përbërësi	Niveli i deklaruar i përbërësit	Toleranca ⁽¹⁾	
		Nën nivelin e deklaruar në etiketë	Mbi nivelin e deklaruar në etiketë
Yndyrë e papërpunuar	< 8	1	2
	8–24	12,5%	25%
	> 24	3	6
Proteinë e papërpunuar	< 8	1	1
	8 - 24	12,5%	12,5%
	> 24	3	3
Hi i papërpunuar	< 8	2	1
	8 - 32	25%	12,5%
	> 32	8	4
Fibër e papërpunuar	< 10	1,75	1,75
	10 - 20	17,5%	17,5%
	> 20	3,5	3,5
Sheqer	< 10	1,75	3,5
	10 - 20	17,5%	35%
	> 20	3,5	7
Amidon	< 10	3,5	3,5
	10 - 20	35 %	35%
	> 20	7	7
Kalcium	< 1	0,3	0,6
	1 - 5	30%	60%
	> 5	1,5	3
Magnez	< 1	0,3	0,6
	1 - 5	1–5	60%
	> 5	1,5	3
Natrium	< 1	0,3	0,6
	1 - 5	30%	60%
	> 5	1,5	3
Fosfor gjithsej	< 1	0,3	0,3
	1 - 5	30%	30%
	> 5	1,5	1,5
Hi i tretshëm në HCL	< 1	Nuk ka limite të fiksuara	0,3
	1 - < 5		30%
	> 5		1,5
Kalium	< 1	0,2	0,4
	1 - 5	20%	40%
	> 5	1	2
Lagështirë	< 2	Nuk ka limite të fiksuara	0,4
	2 - < 5		20%
	5 – 12,5		1
	> 12,5		8%
Vlera energjetike ⁽²⁾		5%	10%
Vlera proteinike ⁽²⁾		10%	20%



⁽¹⁾ Tolerancat janë të shprehura në vlera përqindje absolute (vlera që duhet hequr ose shtuar vlerës së deklaruar) ose vlerës përkatëse të shënuar në “%” (përqindja që i duhet aplikuar nivelit të deklaruar për të llogaritur diferencën e pranueshme). Vlerat absolute i hiqen ose i shtohen rezultatit të analizës, p.sh., nëse vlera e analizës është 15% dhe në tabelë ka një tolerancë me numër absolut (ata numra që nuk kanë përqindje) 15-përqindëshit i hiqet ose i shtohet ai numër që është i shënuar në tabelë. Nëse në tabelë është i shënuar numri 3, atëherë ky numër i shtohet vlerës së rezultatit (15-ës), nëse është nën vlerën e deklaruar dhe bëhet 18, ose i hiqet 15-ës, nëse është mbi vlerën e deklaruar. Vlera e përfutur do të jetë rezultati përfundimtar. Aty ku është i shprehur në përqindje shtimi ose zbritja do të bëhet në përqindje. Kështu vlerës 15 i hiqet ose shtohet 3% i 15-ës (vlera e deklaruar në etiketë).

⁽²⁾ Tolerancat aplikohen, atëherë, kur nuk është fiksuar një tolerancë ose një metodë zyrtare, në bazë të së cilës ushqimi për kafshë tregtohet ose është përcaktuar ndryshe nga një akt tjetër ligjor.

B. Tolerancat për aditivët për ushqimet për kafshë, të etiketuara në përputhje me shtojcat III dhe IV

1. Tolerancat e përcaktuara në këtë pjesë plotësojnë vetëm ndryshimet teknike. Ato zbatohen në aditivët për ushqimet e kafshëve, në listën e aditivëve për ushqimet e kafshëve dhe në listën e përbërësve analitikë.

Për sa u përket aditivëve për ushqimet e kafshëve të listuara si komponentë analitikë, tolerancat zbatohen në raport me sasinë totale të shënuar, si sasi e garantuar në fund të kohëzgjatjes minimale të ruajtjes së ushqimit për kafshë.

Kur niveli i përmbajtjes së një aditivi për ushqimin e kafshëve në një lëndë të parë për ushqimin e kafshëve ose një ushqim të përbërë për kafshë është më i vogël se niveli i deklaruar, zbatohen tolerancat që vijnë⁽¹⁾:

a) 10% e nivelit të deklaruar, nëse niveli i deklaruar është i barabartë ose më i madh se 1000 unitet;

b) 100 unitet, në qoftë se niveli i deklaruar është më i vogël se 1000 unitet, por i barabartë ose më i madh se 500 unitet;

c) 20% e nivelit të deklaruar, në qoftë se niveli i deklaruar është më i vogël se 500 unitet, por i barabartë ose më i madh se 1 unitet;

d) 0,2 unitet, në qoftë se niveli i deklaruar është më i vogël se 1 unitet, po i barabartë ose më i madh se 0,5 unitet;

e) 40% e nivelit të deklaruar, në qoftë se niveli i deklaruar është më i vogël se 0,5 unitet.

2. Aty ku niveli minimal dhe/ose niveli maksimal i një aditivi në një ushqim për kafshët është i fiksuar në aktin e autorizimit përkatës për aditivët e ushqimit për kafshë, tolerancat teknike, sipas pikës 1, zbatohen vetëm kur vlerat e gjetura janë mbi nivelet minimale ose nën nivelet maksimale, sipas rasteve.

3. Niveli maksimal i një aditivi për ushqimet e kafshëve, i vërtetuar nga analizat e laboratorit, me kusht që, sipas pikës 2, të mos tejkalohet, të jetë tri herë më i lartë se toleranca e përcaktuar në pikën 1. Ndërsa, nëse për aditivët që hyjnë në grupin e mikroorganizmave është fiksuar një nivel në autorizimin përkatës për aditivin ushqimor për kafshë, niveli maksimal i caktuar përbën vlerën e limitit maksimal të lejuar.

⁽¹⁾ Në këtë pikë, një unitet është i barabartë me një mg, 1000 UI (unitet ndërkombëtar), e barabartë me 1×10^9 UFC (unitete e formuar në koloni), e barabartë me 100 unitet të aktivitetit të një enzime të shtuar në aditivin ushqimor për kafshë, në gjendje që të transformojë një kg ushqim, sipas rastit.



SHTOJCA III

Deklarimi i detyrueshëm për lëndët e para të ushqimeve për kafshë, siç kërkohet në nënndarjen “ii”, të shkronjës “a”, të pikës 10:

	Lënda e parë për ushqimin e kafshëve, që përmban:	Deklarim i detyrueshëm i:
1	Foragjere dhe foragjere të mëdha	Proteinës së papërpunuar, n.q.s. > 10% Celulozës së papërpunuar
2	Drithëra, të grunjtave	
3	Produkte dhe nënprodukte të drithërave dhe të të grunjtave	Amidonit, nëse > 20% Proteinës së papërpunuar, nëse > 10 % Vajrave dhe yndyrës së papërpunuar, nëse > 5% Celulozës së papërpunuar
4	Fara ose fruta vajore	
5	Produkte dhe nënprodukte të farave ose të frutave vajore	Proteinës së papërpunuar, nëse > 10% Vajrave dhe yndyrës së papërpunuar, nëse > 5% Celulozës së papërpunuar
6	Fara të leguminozeve	
7	Produkte dhe nënprodukte të farave të leguminozeve	Proteinës së papërpunuar, nëse > 10% Celulozës së papërpunuar
8	Tuberozet, rrënjësoret	
9	Produkte dhe nënprodukte të tuberozeve dhe të rrënjëve	Amidonit Celulozës së papërpunuar Hirit të patretshëm në HCl, nëse është > 3,5% të peshës së lëndës së thatë
10	Produkte dhe nënprodukte të industrisë së përpunimit të panxharit të sheqerit	Celulozës së papërpunuar, nëse > 15% Sheqeri total, i llogaritur si sukrozë Hirit të patretshëm në HCl, nëse > 3% i lëndës së thatë
11	Produkte dhe nënprodukte të industrisë së përpunimit të kallamit të sheqerit	Celulozës së papërpunuar, nëse > 15% Sheqeri total, i llogaritur si sukrozë
12	Fara dhe fruta të tjera, produkte dhe nënprodukte e tyre, me përjashtim të atyre të përcaktuara në pikat 2 deri 7, të kësaj shtojce	Proteinës së papërpunuar Celulozës së papërpunuar Yndyrës së papërpunuar, nëse > 10%
13	Bimë të tjera, produkte dhe nënprodukte të tyre, me përjashtim të atyre të përcaktuara në pikat nga 1 deri 8, të kësaj shtojce	Proteinës së papërpunuar, nëse > 10% Celulozës së papërpunuar
14	Produkte dhe nënprodukte të qumështit	Proteinës së papërpunuar Lagështirës, nëse > 5% Laktozës, nëse > 10%
15	Produkte dhe nënprodukte të kafshëve të tokës	Proteinës së papërpunuar nëse > 10% Yndyrës së papërpunuar nëse > 5% Lagështirës, nëse > 8%
16	Peshku dhe kafshë të tjera të detit, produktet dhe nënproduktet e tyre	Proteinës së papërpunuar nëse > 10% Yndyrës së papërpunuar nëse > 5% Lagështirës, nëse > 8%
17	Minerale	Kalciumit Natriumit Fosforit Mineraleve të tjera
18	Përzierje	Proteinës së papërpunuar, nëse > 10% Celulozës së papërpunuar Yndyrës së papërpunuar, nëse > 10% Amidonit, nëse > 10% Sheqeri total i llogaritur si sukrozë, nëse > 10% Hirit të patretshëm në HCl, nëse > 3% i lëndës së thatë



SHTOJCA IV

Të dhënat e etiketimit të lëndëve të para për ushqimet e kafshëve dhe ushqimet e përbëra për kafshë që përdoren për ushqim.

Kapitulli I: Etiketimi i detyrueshëm i aditivëve, sipas kërkesave të shkronjës “dh”, të pikës 9

1. Emrat specifikë të aditivëve ushqimorë për kafshë, numri i identifikimit, sasia e shtuar dhe emri i grupit funksional, duhen deklaruar si vijojnë:

a) aditivët për të cilët është fiksuar një nivel maksimal për të paktën një lloj kafeje që prodhon ushqime për njerëz;

b) aditivët që u përkasin kategorive “aditivë zooteknikë” dhe “koksidiostatikët e histomonostatikët”;

c) aditivët për të cilët janë tejkaluar nivelet maksimale të përcaktuara në aktin juridik që autorizon aditivin ushqimor për kafshë.

Të dhënat në etiketë paraqiten në përputhje me aktin juridik që autorizon aditivin në fjalë.

Sasia e shtuar, sipas pikës 1, shprehet në sasi të aditivit në ushqimin e kafshëve, me përjashtim të rastit kur akti juridik që autorizon aditivin ushqimor për kafshë detyron të shkruhet një substancë në kolonën “Niveli minimal/maksimal”. Në rastin e fundit, sasia e shtuar korrespondon me sasinë e substancës së shtuar.

2. Për sa u përket aditivëve për ushqimet e kafshëve të grupit funksional, vitamina, provitamina dhe substanca të mirëpërcaktuara kimikisht me efekt të ngjashëm, që duhen listuar sipas kërkesave të pikës, etiketa të tregojë sasinë totale të garantuar për të gjithë periudhën e konservimit nën diçiturën “Përbërës analitikë”, në vend të sasisë së shtuar nën diçiturën “Aditivë”.

Grupi funksional	Emri dhe përshkrimi	Emri i shkurtuar
1 h	Substanca për kontrollin e kontaminimit radionuklear: substanca që bllokojnë thithjen e radionukleideve dhe nxisin largimin tyre	Kontrolloret e radionuklidëve
1 m	Substanca për uljen ndotjes së ushqimeve për kafshë nga mikotoksina: substanca që bllokojnë ose ulin thithjen e mikotoksinave, nxisin largimin e tyre ose modifikojnë mënyrën e veprimit të tyre	Reduktuesit e mikotoksinave
1n	Përforsuesit e kushteve higjienike: substanca ose mikroorganizma që kanë një efekt pozitiv mbi karakteristikat higjienike të ushqimeve për kafshë, duke ulur një ndotje mikrobiologjike	Përmirësues të higjienës
2b	Substanca aromatizuese: substanca të shtuara në ushqimet e kafshëve që shtojnë aromën dhe ngrëshmërinë e tyre	Aromatike
3a	Vitamina, provitamina dhe substanca kimikisht të mirëpërcaktuara me efekt të ngjashëm	Vitamina
3b	Përbërje të oligoelementeve	Oligoelemente
3c	Aminoacide, kripëra të tyre dhe të ngjashme me to	Aminoacide
3d	Ureja, derivatet e saj	Ureja
4c	Substanca me efekt pozitiv në mjedis	Përmirësues të ambientit

4. Aditivët për ushqimet e kafshëve të vënë në dukje, në etiketën e ushqimit për kafshë, me fjalë, fotografi ose piktura, të shkruhen sipas kërkesave të pikave 1 ose 2, sipas rastit.

5. Personi përgjegjës për etiketimin i jep blerësit, me kërkesën e tij, emrat, numrat e identifikimit dhe grupin funksional të aditivëve për ushqimet e kafshëve, të cilët nuk janë përmendur në pikat 1, 2 dhe 4. Kjo pikë nuk zbatohet për përbërjet e aromatizuara.

6. Aditivët për ushqimet e kafshëve, që nuk përmenden në pikat 1, 2 dhe 4, shkruhen mbi bazë vullnetare me emrin e tyre ose për substancat aromatizuese, kur ka të paktën emrin e grupit funksional.

7. Duke respektuar piken 6, nëse një aditiv ushqimor për kafshë i grupit organoleptik ose nutrizional shkruhet në etiketë, në mënyrë vullnetare, sasia e tij shkruhet në përputhje me pikat 1 ose 2, sipas rastit.



8. Nëse një aditiv për ushqimet e kafshëve bën pjesë në më shumë se një grup funksional, shkruhet grupi funksional ose kategoria e funksionit të tij kryesor.

9. Duhet shkruar në etiketë të dhënat që i përkasin përdorimit korrekt të lëndës së parë për ushqimet e kafshëve dhe të ushqimeve të përbëra për kafshë të përcaktuara në aktin juridik të autorizimit të aditivit për ushqimin e kafshëve.

Kapitulli II: Etiketimi i përbërësve analitikë, sipas kërkesave të nënndarjes “vi”, të shkronjës “a”, të pikës 11

Përbërësit analitikë të ushqimeve të përbëra, për kafshë të destinuara për prodhimin e ushqimeve për njerëz, shënohen në etiketë pas shprehjes “Përbërës analitikë”, si vijon:

Ushqime të përbëra	Llojet të cilave iu destinohet	Përbërësit analitikë dhe niveli i përmbajtjes
Ushqime komplete për kafshë	Të gjitha llojet e kafshëve Të gjitha llojet e kafshëve Të gjitha llojet e kafshëve Të gjitha llojet e kafshëve Të gjitha llojet e kafshëve Të gjitha llojet e kafshëve Të gjitha llojet e kafshëve Derra dhe shpendë Derra dhe shpendë	Proteina e papërpunuara Fibra të papërpunuara Yndyrë e papërpunuar Hi i papërpunuara Kalcium Natrium Fosfori Lisina Metionina
Ushqime plotësuese për kafshë - minerale	Të gjitha llojet e kafshëve Të gjitha llojet e kafshëve Të gjitha llojet e kafshëve Derra dhe shpendë Derra dhe shpendë Ruminantët	Kalcium Natrium Fosfori Lisina Metionina Magnezi
Ushqime plotësuese për kafshë të tjera	Të gjitha llojet e kafshëve Të gjitha llojet e kafshëve Të gjitha llojet e kafshëve Të gjitha llojet e kafshëve Të gjitha llojet e kafshëve Të gjitha llojet e kafshëve Të gjitha llojet e kafshëve Derra dhe shpendë Derra dhe shpendë Ruminantët	Proteina e papërpunuara Fibra të papërpunuara Yndyrë e papërpunuar Hi i papërpunuara Kalcium $\geq 5\%$ Natrium Fosfori $\geq 2\%$ Lisina Metionina Magnezi $\geq 0,5\%$

UDHËZIM I PËRBASHKËT Nr. 3/2, datë 11.5.2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 24.2.2020 “PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6, pika 3, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të ligjit nr. 88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, të pikës 4,

të VKM-së nr. 100, datë 5.2.2020, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2020”,

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr. 3, datë 24.2.2020, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit për programin e bujqësisë dhe zhvillimit rural”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në kreun IV, pika 1, shkronja “c”, zëvendësohet me formulimin:



“c. Aplikimi *on-line* do të bëhet nga aplikanti në portalin *e-Albania*”. Aplikantët kur e kanë të nevojshme gjatë procesit të aplikimit asistohen *online*, nëpërmjet numrit jeshil 08008383, nga specialistët e Agropika-ve, Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, si dhe shërbimit *online (call center)* nga Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)”.

2. Në kreun IV, pika 1, shkronjat “d”, “e”, “h”, “j”, “k”, “l”, “m” dhe “n”, shfuqizohen.

3. Në kreun IV, pika 1, shkronja “g”, zëvendësohet me formulimin:

“e. Aplikimi *on-line* është i mundshëm përgjatë 24-orëve nga data e hapjes deri në përfundim të periudhës së aplikimit”.

4. Në kreun VI, Masa 1, nënndarja “i”, shkronja “d”, shfuqizohet.

5. Në kreun VI, Masa 2, nënndarja “i”, shkronja “j”, shfuqizohet.

6. Në kreun VI, Aplikimi për masat 1-6, zëvendësohet me formulimin:

“APLIKIMI PËR MASAT 1-6.

Aplikanti/përfaqësuesi i tij ligjor kryen regjistrimin në portalin *e-Albania* me kartën e identitetit. Pas regjistrimit, aplikantit i shfaqet në sistem dritarja “Aplikim për skemat kombëtare”. Aplikanti plotëson NIPT-in e fermerit, përzgjedh masën mbështetëse dhe plotëson (vetëdeklaron) sasinë që ka (krerë, sipërfaqe) dhe jep komandën “dërgo”.

Rubrikat që shfaqen në sistem janë:

1. Masa mbështetëse;

2. Të dhënat e kartës së identitetit të aplikantit (në rast kur ka përfaqësues, të dhënat në formular të jenë ato të aplikantit);

3. Statusi nëse aplikanti ka NIPT aktiv;

4. Vendndodhje e aplikimit;

5. Sasia e aplikuar (krerë/koshere/sipërfaqja në ha);

6. Vlera e aplikimit;

7. Numër kontakti;

8. Konfirmimi për raste kur aplikanti është i regjistruar në QKB, nuk është debitor ndaj Drejtorisë së Tatimeve;

9. Të dhëna për sigurimet shoqërore koherente, nëse janë paguar në momentin e aplikimit;

10. Kodi i aplikimit dhe koha e regjistrimit në sistem, të cilat gjenerohen automatikisht nga sistemi;

11. Aplikanti pranon që të dhënat e tij personale të përdoren vetëm për qëllim të këtij aplikimi. AZHBR-ja garanton mbrojtjen e të dhënave personale të aplikantëve sipas ligjeve në fuqi.

12. Aplikanti informohet se nuk mund të përfitojë nëse është debitor ndaj AZHBR-së, dhe/ose MBZHR-së dhe/ose nuk ka derdhur detyrimet koherente për sigurimet shoqërore. Afati përfundimtar për dorëzim dokumenti është deri në 20 ditë pune nga data e përfundimit të aplikimeve.

Procedura e aplikimit përfundon me mesazhin në sistem “Aplikimi u regjistrua me sukses”.

7. Në kreun VII, pika 3, në fund të fjalisë, hiqen fjalët “...si dhe listën e printuar në të gjitha pikat e pranimit të aplikimeve”.

8. Në kreun VII, pika 4, zëvendësohet me formulimin:

“4. Të gjithë aplikantët mbi vijën e financimit, sipas evidentimeve në listën e shpallur, kanë afat deri në 20 ditë pune nga data e përfundimit të aplikimeve, të dorëzojnë dokumentet e kërkuar në Agropikën më të afërt ose në zyrat qendrore të AZHBR-së, ose me Postë në zyrat qendrore të AZHBR-së. Lista e Agropikave jepet në aneksin 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

Inspektori/specialisti i Agropikës për çdo dokument të paraqitur nga aplikanti/përfaqësuesi ligjor apo çdo dokument tjetër të gjeneruar nga regjistrat publik, mban procesverbal në dy kopje, të marrjes në dorëzim të dokumenteve dhe i dërgon në AZHBR, Tiranë.”.

9. Në kreun VII, pas pikës 9, shtohet pika 9/1, me këtë formulim:

“9/1. Para pagesës, në momentin e verifikimit, të gjithë aplikantët me status fermer ose person fizik dhe juridik, që kryejnë aktivitet për prodhimin bujqësor dhe blegtoral, duhet të plotësojnë formularin e regjistrimit të fermës sipas aneksit 2, të udhëzimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj



ANEKSI 1. LISTA E AGROPIKAVE

Qarku	Nr.	
Berat	1	AGROPIKA Berat
Dibër	1	AGROPIKA Dibër
	2	AGROPIKA Mat
Durrës	1	AGROPIKA Rrashbull, Durrës
Elbasan	1	AGROPIKA Elbasan
	2	AGROPIKA Librazhd
Fier	1	AGROPIKA Fier
	2	AGROPIKA Lushnjë
Gjirokastrë	1	AGROPIKA Gjirokastrë
	2	AGROPIKA Përmet
Korçë	1	AGROPIKA Pogradec
	2	AGROPIKA Korçë
Kukës	1	AGROPIKA Kukës
Lezhë	1	AGROPIKA Lezhë
Shkodër	1	AGROPIKA Shkodër
	2	AGROPIKA Pukë
Tiranë	1	AGROPIKA Tiranë
	2	AGROPIKA Kavajë
Vlorë	1	AGROPIKA Vlorë
	2	AGROPIKA Sarandë

URDHËR

Nr.142, datë 13.5.2020

**“PËR PËRCAKTIMIN E ADRESAVE TË
POSTËS ELEKTRONIKE PËR
KOMUNIKIMIN ZYRTAR ME
MINISTRINË E DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 37, pika i, të ligjit nr.26/2019 “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”, me qëllim lehtësimin e procedurave të komunikimit me përmbartuesit privatë,

URDHËROJ:

1. Çdo përmbartues gjyqësor privat, si dhe çdo zyrë përmbartimore, të depozitojë pranë Ministrisë së Drejtësisë, një adresë të postës elektronike, funksionale.

2. Çdo ndryshim i adresës së postës elektronike të sipërcituar duhet të njoftohet,

Faqe| 5586

brenda dy ditëve punë nga kryerje e këtij ndryshimi pranë Ministrisë së Drejtësisë, elektronikisht në adresën e administruar nga struktura përgjegjëse e rregullimit të profesioneve të lira, me qëllim përcjelljen e këtyre komunikimeve dhe me shkresë.

3. Përmbartuesi gjyqësor privat apo zyra përmbartimore regjistron këtë të dhënë dhe çdo ndryshim të saj në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të legjislacionit përkatës.

4. Çdo komunikim elektronik i Ministrisë së Drejtësisë që lidhet me ushtrimin e profesionit të përmbartuesit gjyqësor privat, të kryhet përmes kësaj adrese elektronike.

5. Me dërgimin e komunikimit në adresat e postës elektronike të përcjella, do të konsiderohet se njoftimi është kryer.

6. Në rast të mungesës së njoftimit nga përmbartuesi gjyqësor privat mbi ndryshimin e adresës së postës elektronike, të parashikuar në pikën 2 të këtij urdhri, njoftimi do të konsiderohet i kryer në adresën e deklaruar më parë prej tij.

7. Dhoma Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë, të marrë masa për zbatimin e



këtij urdhri dhe të përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë një listë të përditësuar me adresat elektronike për përmbaruesit, brenda dhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

8. Ngarkohet struktura përgjegjëse e monitorimit/rregullimit të profesioneve të lira, në Ministrinë e Drejtësisë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

VENDIM
Nr. 9, datë 11.5.2020

**PËR TRANSFERIMIN E FUNKSIONIT
TË MBLEDHJES SË TARIFAVE PËR TË
GJITHA KATEGORITË E MBAJTËSVE
TË TË DREJTAVE TË AUTORIT DHE
TË DREJTAVE TË TJERA TË LIDHURA
ME TO, NË ADMINISTRIMIN
KOLEKTIV DHE DREJTIMIN E
SPORTELEUT UNIK TË ADMINISTRIMIT
TË SË DREJTËS SË AUTORIT – SUADA**

Në zbatim të nenit 138, të ligjit nr. 35, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 18.1.2017, “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit”; të vendimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit nr. 2, datë 20.4.2017, “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA)” dhe vendimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit nr. 8, datë 19.11.2018, “Për transferimin e funksionit të mbledhjes së tarifave për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në administrimin kolektiv dhe drejtimin e sporteli unik të administrimit të së drejtës së autorit – SUADA”, Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA), pas konsultimit të zhvilluar në mbledhjen e datës 11.5.2020, nëpërmjet platformës ZOOM, me rend dite, zgjedhja e Agjencisë unike të cilës i kalon funksioni kolektiv i mbledhjes së tarifave të

shpërblimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to,

KONSTATON SE:

Me vendimin e KKDA-së nr. 8, datë 19.11.2018, Agjencia “Albautor” është zgjedhur në drejtimin e sporteli unik të administrimit të së drejtës së autorit – SUADA, me afat 1-vjeçar (njëvjeçar).

Në përfundim të afatit, në bazë të nenit 138, të ligjit nr. 35, datë 31.3.2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, Agjencitë e Administrimit Kolektiv (AAK) me anë të një marrëveshjeje me shkrim bien dakord dhe vendosin cilës prej tyre do t’i transferohet funksioni i mbledhjes së tarifave për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave. Në pamundësi të arritjes së një marrëveshjeje, e drejta e zgjedhjes së AAK-së që do të drejtojë SUADA-n i kalon KKDA-së.

Me qëllim zgjedhjen e AAK-ve, KKDA-ja njoftoi hapjen e procesit të konkurrimit të AAK-ve. Në mbledhjen e vet të radhës, në datën 27.4.2020, me rend dite, prezantimi i platformave të agjencive të cilat shprehën interesin për kalimin e funksionit kolektiv të mbledhjes së tarifave të shpërblimit në kuptim të nenit 138, të ligjit 35/2016, si dhe drejtimin prej saj të sportelit unik SUADA, mori në shqyrtim dosjet me propozimet e mëposhtme:

1. Kërkesa e Agjencisë “Albautor” për Sportelin Unik për të Drejtat e Autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, me nr. protokoll hyrës nr. 1388, datë 9.3.2020;

2. Kërkesa e Agjencisë “AKDIE” për Sportelin Unik për të Drejtat e Autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, me nr. protokoll hyrës nr. 1247, datë 3.3.2020;

3. Kërkesa e Agjencisë “FMAA” për Sportelin Unik për të Drejtat e Autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, me nr. protokoll hyrës nr. 1353, datë 6.3.2020;

4. Kërkesa e Agjencisë “GRAMM-A” për Sportelin Unik për të Drejtat e Autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, me nr. protokoll hyrës nr. 1523, datë 24.3.2020.

Agjencia “AKDIE” përmes *e-mail*-it të datës 27.4.2020 u tërhoq zyrtarisht nga gara.



Kërkesa e Agjencisë “GRAMM-A” nuk u pranua për konkurrimin për sportelin unik SUADA, në kushtet e vendimit të formës së prerë të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 158, datë 31.1.2020, i cili ka revokuar urdhrin e Ministrit të Kulturës 2018 “Për licencimin e shoqatës GRAMM-A, si agjencia e administrimit kolektiv në fushën e mbajtësve të të drejtave të prodhuesve të fonogramave dhe videogramëve”.

Përveç dokumenteve shkresore të depozituara, AAK-të “Albautor” dhe “FMAA” prezantuan me përfaqësuesit e tyre pranë KKDA-së, në datën 27.4.2020, platformat përkatëse për drejtimin e sportelit unik SUADA.

KKDA-ja, prej vitesh konstaton se ndërmjet AAK-ve ekziston një frymë jo e mirë bashkëpunimi, fakt ky që manifestohet në pamundësinë e vendimarrjeve të organit më të lartë të qendrës, SUADA. Me synimin për të krijuar frymën e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit ndërmjet AAK-ve, KKDA-ja, pasi dëgjoi prezantimet e platformave për drejtimin e qendrës SUADA, me kërkesën nr. 1864 prot., datë 29.4.2020, u bëri thirrje të gjithë AAK-ve për arritjen e një marrëveshje për një kandidaturë për pozicionin e drejtorit ekzekutiv të SUADA-s që nuk ka ndonjë konflikt interesi me AAK-të apo SUADA-n. AAK-të u përgjigjën me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të SUADA-s, të datës 4.5.2020, duke mos arritur një konsensus të përgjithshëm të të gjithë AAK-ve.

Misioni i KKDA-së është garantimi dhe mbrojtja e mbajtësve të së drejtës, subjekt të të drejtave të autorit, për sa i përket shpërblimit për shfrytëzimin e të drejtave me karakter pasuror dhe jopasuror në tregun intelektual. Përveç detyrimit të përmbushjes së këtij misioni, e drejta e vendimarrjes në përzgjedhjen e AAK-së për drejtimin e SUADA-s, ligjvënësi e ka parashikuar në funksion të zhbllokimit të gjendjeve që pamundësojnë marrëveshjen e AAK-ve për drejtimin e SUADA-s.

Në kushtet kur përsëri AAK-të nuk arritën të gjejnë dakordësinë, KKDA-ja mori në analizë propozimet e dy AAK-ve, përkatësisht “Albautor” dhe “FMAA”, si dhe në referim të pyetjeve dhe përgjigjeve të administruara në seancat dëgjimore të datës 27.4.2020, por edhe të kritereve që kërkojnë se, SUADA duhet të ketë në drejtimin e saj një AAK e cila ka kohëzgjatje

të aktivitetit të subjektit ndër vite dhe provon se ka logjistikën më të përshtatshme, ekspertizën profesionale për mbulimin e territorit, kontrata të përfaqësimit të ndërsjellë me agjenci homologe dhe njohje ndërkombëtare, të ketë pasuritë e platformës më të përshtatshme dhe me koston më efektive për administrimin e të drejtave, të zotërojë infrastrukturën më të përshtatshme, përfshirë atë elektronike, e cila garanton respektimin e transparencës në mbledhjen dhe shpërndarjen e të ardhurave për anëtarët e saj dhe të zbatojë me përpikëri dispozitat për procedurën e mbledhjes së shpërblimeve, sipas ligjit për të drejtën e autorit, KKDA konstaton se:

Agjencia “Albautor”, në cilësinë e drejtuesit të SUADA-s, nuk ka implementuar një sistem elektronik icili do të garantonte transparencën në mbledhjen dhe shpërndarjen e të ardhurave të AAK-ve. Nga ana tjetër konstatohet se forma e menaxhimit të SUADA-s nga “Albautor” ka sjellë mungesë bashkëpunimi dhe nuk ka arritur të vendosë një ekuilibër mes AAK-ve, fakt i cili është bërë shkak për lindjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet tyre.

Nga ana tjetër, platforma e drejtimit të SUADA-s nga Agjencia “FMAA” edhe pse një platformë e pa testuar në praktikë, krijon bindjen se nëse do të zbatohet në tërësinë e saj dhe brenda afateve kohore të propozuara mund të rezultojë e suksesshme.

Sa më sipër, duke administruar të gjithë informacionin e nevojshëm dhe pas shqyrtimit të platformave të paraqitura, Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit, në zbatim të nenit 138, të ligjit 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”

VENDOSI:

1. Transferimin e funksionit të mbledhjes së tarifave për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në administrimin kolektiv, në bazë të nenit 138, të ligjit 35/2016, agjencisë së administrimit kolektiv “FMAA”, nga data 11.5.2020 deri në datën 31.12.2021.

2. Brenda 1 (një) muaji nga publikimi i këtij vendimi duhet të bëhen ndryshimet e nevojshme



në aktet e Qendrës SUADA, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3. Brenda 6 (gjashtë) muajve nga publikimi i këtij vendimi duhet të vihet në funksionim:

- Platforma e propozuar;
- Platforma elektronike e cila mundëson transparencën në mbledhjen dhe shpërndarjen e të ardhurave.

4. Pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, zbatohet neni 138, i ligjit 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

5. Mënyra dhe përqindjet e ndarjes së tarifave dhe shpërblimit të mbledhur ndaj AAK-ve të kryhet në zbatim të pikës 3, të nenit 138, ligjit 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”.

6. Për sa nuk bien ndesh me këtë vendim, pikat e miratuara në vendimin nr. 4, datë 10.10.2017, të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit “Për transferimin e funksionit kolektiv të mbledhjes së tarifave të shpërblimit për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to,

drejt njëres prej agjencive të administrimit kolektiv dhe për drejtimin e sportelit unik për administrimin e të drejtës së autorit - SUADA”, zbatohen nga SUADA.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës, si dhe në Fletoren Zyrtare.

8. Kundër vendimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit, palët kanë të drejtë të ankohen në gjykatën administrative kompetente brenda afateve të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative. Afati i ankimit, llogaritet nga data e njoftimit/shpalljes të këtij vendimi.

9. Ngarkohet sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR I KËSHILLIT KOMBËTAR
PËR TË DREJTËN E AUTORIT
Ines Muçostepa

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë